

HENRIK LACAJ

## PJETËR BUDI VJERSHËTOR I PARË I LETËRSISË SONË

Sikur krahas prozatorëve të vjetër të vendit tonë të kishte dalë edhe një shkrimtar vetëm me një vepër në vjersha ose me një tufë vjershash të ndryshme prej trimijë e sa vargjesh, s'ka dyshim se edhe ai do të kishte zanë vendin e vet të denjë ndërmjet shkrimtarëve të tjerë dhe vepra e tij do t'ishte bamë objekt studimi dhe do të kishte pasë vlerën dhe randësinë e vet të veçantë në fushën e poezisë reflekse të letërsisë sonë. Ja, pra, se edhe vendin e një shkrimtari të tillë nuk e la të zbrazët pikrisht Pjetër Budi i cili, përveç një lande aq të vëllimshme në prozë, na la edhe 707 strofa katërshe me rimë të alternueme në Doktrinën e kërshënë, 41 strofa të tilla në Pasqyrën e të Rrëfyemit dhe një vjershë prej 38 vargjesh me tetërokësh të dyfishtë në Ritualin Roman.

Natyrisht, siç ndodhi edhe për shkrimtarët e tjerë të vjetër, vepra e Budit tërhoqi vemendjen e studjuesve ma së pari e në mënyrë të veçantë në lamin gjuhësor; mirëpo ajo ka të dhana të mjaftueshme për ta studjue edhe në lamiye të tjera. Dhe në të vërtetë, derisa kemi të bajmë me një shkrimtar i cili kaloi përtej sferës së puntorëve të tjerë të epokës së vet, tue sjellë diçka të re sidomos me hartimin e me botimin e vjershave të veta, atëherë mund të thomi se ky krijim i ri i letërsisë sonë të vjetër si nga ana patriotike-shoqërore, ashtu nga ana letrare e metrike paraqet thuejse të njajtin interes e vlerë që ka edhe në fushën e gjuhësisë. Mbi natyrën dhe vlerën e vjershave të Pjetër Budit diçka asht thanë në Monografinë tonë, dorëshkrim në arkivin e Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, ashtu edhe në tekstin e Historisë së letërsisë shqipe. I pari që asht shprehë në mënyrë pozitive sidomos mbi randësinë shoqërore-politike dhe mbi kuptimin alegorik të vjershave të Budit ka qenë poeti arbresh Zef Skiro, mendimin e të cilit në këtë drejtim do ta theksojmë nga fundi. Shpesh shtrohet pyetja se deri në ç'shikallë mund të jenë origjinale vjershat e Budit. Ç'asht e drejta një përgjigje të sakët nuk jemi në gjendje ta japim. Për të gjykue objektivisht, duhet t'u referohemi fjalëve të vetë shkrimtarit, i cili në parathaniën e Doktrinës thotë pikërisht kështu «... e tue pamë ashtu ende se këta diesit e letërorët e hollë që u vjen ndore ashtu gjakafshë me ndihmuom, e lanë shkret e gja ma s'po ndimonnjën, ma s'keshe tjetër qish me bamë veçse hina mbarë e mbrapë sido munda shkrova mbë gjuhë tanë ma parë do kapituj të Ditës së gjyqit qi gjeta shkruom atit shumë ncë ndershim e ncë divoçim frat Palit prej Hasi, të cijtë ende me do të tjera të nçtuome disa herë tue i shkruom, i shkrova kur tue pamë se ishin për të madhe ndihmë e frujt të shpirtit të atij populli e aq ma tepër të disa Priftëne që dëshironjën me i pasun,

hina për gjithë ditë ka pak tue nçtuom, shkrova ende ca të tjera kafshë sa mujta ndë tjera gjuhësh tue i nkthym mbë gjuhu tanë». Me një shqyrtim të vemendshëm të këtyne fjalëve të vetë autorit besojmë se mund të çfaqim një mendim që mund t'i afrohet së vërtetës. Së pari këtu duhet të pranojmë se Pjetër Budi flet për shkrime që përfshijnë edhe vjershat. Pastaj ai nxitim që shprehet me frazën «hina mbarë e mbrapë sido munda», tregon se koha s'priste e, mbasi Budi konstaton me keqardhje se mjaft njerëz të pendës që mund të jepnin shumë, nuk po shkruenin, atëherë ai vetë i përvishet punës edhe në një gjini letrare, për të cilën s'kishte ndoshta aq prirje apo talent. Budi për nisjen e veprimtarisë së vet edhe në fushën e vjershimit merr shkas nga disa vjersha të shkrueme prej fra Palit nga Hasi, dhe këtë e vërteton parafrazimi i kangës liturgjike «Dies irae» që asht pikërisht vjersha e parë e «Doktrinës së kërshenë». Vetë Budi në titullin e kësaj pjese rrëfen se ajo ka pësue ndryshime siç e thotë vetë «për të pajtuomit e fjalëve», d.m.th. për arësye të rimës. Kur Pjetër Budi, mbasi i ka nxjerrë vetë në disa kopje dhe ka shpërnda në popull vjersha të këtij lloji, shef se ato mirëpritëshin dhe kërkoheshin edhe të tjera, atëherë ai nuk ngurron të rrokë pendën e të vazhdojë punën, të shkruiejë vetë vjersha dhe, si e thotë shprehimisht, disa edhe t'i përkthejë. Në gjithë ato vargje, që përmbajnë të tri veprat e Budit, nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe pjesë të marruna nga fra Pali, por prap mund të thomi se Budi, tue i kalue nëpër duer, me shtesa e ndryshime që mund të bante herë mbas here, i brumosi në mënyrë të tillë sa që ato në fund u transformuen, si fryt i punës dhe i mundimit të tij, tue fitue origjinalitet në gjuhë, në stil dhe në varg. Me sa dihet ose ma mirë nga pohimet e atyne që e kanë pasë ndër duer veprën e Belarminit «Dottrina cristiana», të cilën e përktheu Budi, ai libër përmban vetëm shpjegimin e besimit në formë pyetje dhe përgjigje dhe nuk ka asnjë varg. Këtej del se vjershat e Doktrinës së përkthyme shqip janë një shtojcë e vetë Pjetër Budit.

Pra, meqënëse ky shkrimtar, me sa na rezulton deri sot, asht vjershtëtari ma i parë i letërsisë sonë, del detyra të shqyrtohen dhe të studjohen edhe nga ana teknike vjershat e tija. Budi, siç dihet, përdor vargun tetërrokësh në strofa katërshme me rimë të alternueme. Vjersha me një strukturë të tillë përmban Doktrina dhe Pasqyra e të Rrëfyemit, kurse në Ritualin Roman, sikurse e thamë, kemi 38 vargje me tetërrokësh të dyfishtë dhe me rimë të brendëshme, kështu që këtu na del një inovacion në vargimin shqip.

Kuptimplotë asht fakti që P. Budi, në një sasi kaq të madhe vjershash me tema të ndryshme, i përmbahet vetëm një mase metrike; kjo tregon se që në kohë të vjetra gjuha jonë gjente shprehje të natyrshme e të lehtë në tetërrokëshin; leximi dhe recitimi i tij, siç e shohim edhe sot, dilte q'atë herë i rrjedhëshëm dhe i përvetësueshëm edhe nga masa e popullit të pashkollë. E vërtetë se edhe dhjetërrokëshi asht një nga vargjet popullore të vendit tonë, por ndërsa kjo masë metrike, siç e shohim të «Martesa e Halilit» te «Gjergj Elez Alia» e gjetiu, këndohet prej rapsodit me melodi dhe me shoqënimin e lahutës, përkundrazi, tetërrokëshi, për hir të asaj shkathtësie e rrjedhëshmënie që zotnon edhe si varg i shkurtën, e ban poetin popullor ta recitojë apo ta deklamojë edhe pa melodi, sikurse vërtetohet në shumë rase. Kjo asht një nga karakteristikat e tetërrokëshit. Pastaj në këtë varg popullor, tue mos përjashtue pjesë edhe nga letërsia reflekse, gjejmë shpesh një tipar tjetër mjaft origjinal, gjejmë një theksim të veçantë që e thyen sistemin

trokaik tue mos iu mbajtë rregullave të vargnimit që jep stilistika d.m.th. çfaqet theksi tonik mbi të dytën rrokje (e shpesh edhe mbi të parën). Kjo mënyrë kadence, simbas mendimit tonë, nuk duhet t'i mvishet gjithmonë autorit si mungesë aftësie ose si një farë moskujdesimi në thurje të vargjeve, por si diçka e natyrshme që del në mënyrë të vetvetishme, tue sjellë edhe një farë larmie ritmike, e cila vlen për të thye monotoninë në tetërrokësha të gjatë. Një fenomen i tillë çfaqet edhe në ndonjë gjuhë tjetër si p.sh. në italishten, sikurse do të shohim në një shembull të dhanë ma poshtë. Megjithatë duhet të kemi parasysh se ky sistem vjershor nuk mbahet në mënyrë konstante në të gjitha vargjet, por alternohet me tetërrokëshin e rregulltë. Pikërisht një sistem dhe një ritëm të tillë e gjejmë shpesh edhe në vjershat e Pjetër Budit. Pra mund të thomi se kanë origjinalitet në kadencë vargje të tilla si në këto strofa:

Ku janë ata pleq bujarë  
qi qenë përpara ne  
e ata trima sqimatarë  
të çpejtë si rrufe?

Ku janë ata djem të rij  
të bukur të lulëzuom  
si pate pamë me sy,  
me ta folë e ligjëruom?

Ku janë ata Perandorë  
gjithë shekullit nalcuom  
mbë krye me një kunorë  
gurësh cë paçmuom?

Ku janë ata letërorë  
t'urtë e dies të ndëgjuom  
të bardhat posi vdorë  
letëra tue kënduom?

Ku janë ato gra e vasha  
ndë sqimë e ndë madhështi  
me petëkat e mëndafshhta  
nalcuom mbë zotëni?

Gjithë mortja i rrëzoi  
sikur i pret me shpatë  
për të rij s'i shukoi  
as të vobeg as të begatë.

Këtu shohim se brenda 6 strofave d.m.th. në 24 vargje vetëm 5 prej tyre mbajnë theksin e rregulltë, kurse të tjerat kanë ritmin karakteristik për të cilin folëm. Për të pa se ky sistem vjershor nuk del vetëm te vjershat e Budit por çfaqet në mjaft poetë të tjerë të mavonshëm deri në kohët tona si një tipar i natyrshëm dhe tradicional

i tetërrokëshit, mund të na vlejné si shëmbull krahasimi e paralelizmi në theksim disa nga vargjet e Naimit në kangën e II të Historisë së Skënderbeut:

Dimëri kish shemëtuar  
faqen e dheut q'ish tharë,  
moti q'ishte egërsuar  
kish fishkur lulet e barë.  
Shpeshtë ishin të qetë,  
as lëvrinin as këndonin,  
kishin zënë foletë,  
dridheshin edhe rënkonin;  
e retë sterrë të zeza  
dhen'e kishin mbuluar  
q'ish i bardhë porsi veza  
në mest të tyre qëndruar.  
Gjë e gjallë s'pipërinte,  
jeta gjithë ishte shuar,  
ish thëllim e frynte e binte,  
bota ishte e shkretuar.

Edhe këtu brenda 16 vargjeve vetëm 5 paraqiten me ritmin e rregullt të tetërrokëshit, kurse të tjerat mbajnë strukturën dhe ritmin e lartpërmendun. Kështu pra në këtë sistem karakteristik vjershimi gjejmë afëri tonike ndërmjet vargjeve të Budit dhe të Naimit. Siç e përmendëm ma sipër, një theksim të tillë e gjejmë aty-këtu edhe në vjersha të gjuhës italishte si në këto vargje:

Oh, quant' egli è gran pietate  
delle donne di Messina,  
vedendole scapigliate,  
portando pietra e calcina.

Sikurse shofim, dy vargjet e fundit mbajnë theksin e parë tonik mbi rrokjen e dytë, pra janë në analogji të plotë me tetërrokëshin karakteristik që çfaqet në gjuhën tonë.

Një tipar tjetër në tetërrokëshin e Pjetër Budit asht edhe llogaritja e zanores së gjatë në trup të vargut për dy rrokje. (Natyrisht, këtu nuk asht fjala për rrokjen e fundit të vargut që, simbas rregullave metrike, ka vleftën e dy rrokjeve). Për këtë na udhëzon vetë grafia e Budit, i cili për zanoret e gjata, si edhe vetë Buzuku, përdor zanoret dyfishe për të përlligjë një zgjatim të tillë, karakteristikë sidomos e gegnishtes së veriut. Aq ma tepër në varg, aty ku bie theksi tonik, shkrintari ynë përfiton me anën e zanores së gjatë të theksueme të nxjerrë një tingëll që jep tonin dhe si të thuash përshtypjen e dy rrokjeve, si në këto vargje:

E nji *zaa* si trumbetë

E në *gjyyq* t'i gërshesë

Kuur letëra të dalë  
 Ndee vonë ata u mpoqën  
 Tue paamë aq kafshë  
 Ata *syy* si luqierre  
 Saa s'mund me kallëzuom  
 E ndër *saa* kundërshti  
*Tuu* thanë mjera unë  
 Oo si një gurrë e gjallë.

Meqenëse një nga elementet e kushtëzueme të vargut tetërokësh asht edhe rima, duhet t'i hedhim një vështrim përdorimit dhe trajtimit të saj nga ana e Pjetër Budit, derisa kemi të bajmë me një shkrimtar që na dha një sasi të konsiderueshme vargjesh. Si paraqitet, pra, rima në vjershat e Budit? Ajo, sikurse shifet mirë, del me një kufizim të theksuem brenda një rrethi që shkon tue u përsëritë nga një radhë vargjesh në tjetrën. Po të lexojmë edhe një numër të kufizuem prej vjershave të Budit, me një herë do të kujtohemi se asht pikërisht diftongu *uom* ose *uo* ai që mbizotënon si rimë; pastaj vijnë termat që kanë për fundore zanoren *i* sepse sasia e *tyne* asht mjaft e madhe pra e volitshme për rimë e kështu me radhë të thomi edhe për ca fundore të tjera tipike dhe të përshtatëshme për këtë qëllim. Një kufizim i tillë në vjershat e Budit përligjet me të drejtë nga disa arsëye objektive. Ma së pari duhet të pranojmë se rimari në gjuhën shqipe paraqitet mjaft i ngushtë nga shkak i larmisë së madhe të fundoreve në termat e ndryshme, gja kjo që e ban të vështirë gjetjen e fjalës korresponduese në tingëll. Pastaj duhet të kemi parasysh faktin se Budi vjershon në një kohë në të cilën nuk dihet nëse kishte ndonjë model në shqipet përveç vjershave të fra Palit, megjithëse nuk mund të mohohet se në Budin edhe si vjershëtar mund të hetojmë gjurmët e një tradite letrare edhe në poezi. Së treti rima, ku e ku tepër e përsëritun në ato vargje, përligjet nga fakti se shkrimtari ynë shkruente vjersha në një periudhë në të cilën nuk priste koha, pra duhej shkruet sa shumë e sa ma shpejt për të ushqye shpirtnisht një publik që tregonte dashuni dhe etje për vjersha në gjuhën amtare. Së fundi nuk duhej të pretendohet ma tepër se kaq prej një shkrimtari të tillë si Budi i cili, siç u tha, nuk kishte vetitë apo talentin e një poeti, ndonse ka pasë edhe ka poetë që në punën e të rimuemit kanë gjetë edhe gjejnë vështirësi e pengesa jo të lehta. Megjithëkëtë mund të themi se vjershat e P. Budit të thuruna në tetërokësha dhanë mundësi praktike përvetësimi, të mësuemi përmendësh edhe nga masa e pashkollë që i dëgjonte prej të tjerëve.

Megjithëse Pjetër Budi shkroi edhe në vargje ma tepër nga një dëshirë e zjarrtë që të mësonte dhe të edukonte bashkatdhetarët me anën e një mjeti tërheqës, siç ishte vjersha, prap se prap mund të thomi se edhe në këtë fushë ai pati dorë të mbarë edhe na dha aty këtu pjesë

të cilat rrëfejnë shije letrare dhe përpjekje për të nxjerrë diçka të bukur e tërheqëse. Edhe Budi, pra, në vjershat e veta me shprehje e përshkrim të gjalla herë me forcë e herë me ambëlësi, simbas subjektit që trajton dhe simbas episodit që përshkruen, arrin të tërheqë vemendjen e lexuesit dhe të zgjojë emocione në zemrën e tij. Ja p.sh. se si Budi përshkruen zinë e natyrës dhe tronditjen e njerëzve:

Drita nqiellshit u shuo  
ditënë u ba terrë,  
gjithë dheu u trishtuo,  
shungulloi mjet ndë ferrë.

Sa gjithë tue pamë  
me fjalë s'mund flisnë,  
ngrusht vetiu tue ramë  
gjithë ndë dhe u përmbysnë.

E dielli ke u nxi  
përpara tyne u shuo,  
sikur një thes i zi  
gjithë drita iu shuo. . .

Apo përmytjen e botës:

Kush desh t'u vin përkrye  
aty mbet e urdhënoi,  
dera e qiellës u thye,  
vienat i lëshoi.

E avisi u tfunduo,  
leqiejt i debërtoi,  
megjithanet u vërshuo  
gjithë dhenë e mbuloi.

E shiu në qiellshit po bij  
nuk pushoi ditë e natë,  
katerdhjetë dit t'ungji  
posi thot ndë ligjt plakë.

Sa ujët u shumuo  
gjithë malet i kaptoi,  
gjithë dheu u faruo,  
kafshë e gjallë kund s'shpëtoi.

Sikurse e kemi theksue edhe në ndonjë rasë tjetër, te vjershat e Budit gjejmë edhe dramatizim episodesh të nxjerra nga Bibla, një nga të cilat asht edhe përshkrimi i vrasjes së Abelit nga Kaini. Aty bien në sy

shprehjet dhe frazat efikase krejt popullore me tonin e rrebtë e kërcënues plot namë e mallkime që radhiten nga fundi dhe janë krejt të natyrës shqipe si p.sh. këto vargje:

Qish bane, qen i zi,  
mse hine ndë gjakësi,  
o dheu përpara ty  
qoftë nkthyem ndë të zi.  
Puna mos të voftë mbarë  
posi zemra të dashtë,  
fara mos të biftë nd'arë,  
as frujtin mos ta dhashtë,  
qi hape gojën tande,  
pive gjaknë e ty vëlla,  
e vrave me dorë tande,  
gjithë qiella të pa.

Kemi përshtypjen se po të kufizoheshim vetëm me analizën e formës së jashtme të vjershave të Budit, do të dilte diçka jo e plotë; do të mbetej e zbehtë fizionomia e Pjetër Budit si vjershëtor, sikur të mos shikohej edhe brendia, edhe subjekti që Budi trajton në këto vjersha, sepse në të vërtetë ka aty diçka që lidhet me rrethanat, me kushtet historike, me tendencat e kohës. Po të vështrijmë me vemendje frymën që i përshkon vjershat e Budit, megjithëse me subjekte të nxjerra nga dhiata e vjetër dhe e re, do të shohim se si e trajton shkrimtari këtë tematikë dhe ku e ka pikësynimin. Dhe pikërisht këto qenë arësytet që e shtynë poetin arbresh Zef Skironë t'i jepte randësinë e duhur argumentit që përmbajnë vjershat e Budit dhe ta radhiste për këtë punë shkrimtarin tonë krahas poetit Milton, autorit të Paraisës së humbun dhe krahas poetit Andreini, autorit të veprës «Adamo», të dy shkrimtarë të shekullit XVII, për të cilët, ashtu sikurse edhe për Pjetër Budin, dhjata e vjetër dhe e re qenë gurrë kryesore në hartimin e veprave të tyre. Ku synon pra ky shkrimtar me vjershat e veta? Këtu i referohemi mendimit të poetit të lartpërmendun i cili thotë: Nëqoftëse në disa vende të veprës së madhe të Miltonit u dha mundësia të gjindej ndonjë provë e anmiqësisë së madhe të poetit anglez kundrejt Stuartëve, aq ma me të drejtë askush nuk mund të mohojë se askeptizmi ma i rrebtë nuk arrin të fshehë në vargjet e Pjetër Budit aspiratat e tija politike e kombëtare, derisa duket qartë se ai ndonjë herë në mëkatin dhe në djallin shikon dhe mallkon Turkun e urrejtun, shkelësin e atdheut të tij. Dhe në të vërtetë ai qortim e kushtrim, që Budi u drejton bashkatdhetarëve për një jetë të pastër, për qëndresë në virtyt, lutjet e vazhdueshme për lirim nga gjendja e mjerueshme shprehin realitetin e idhët të kohës dhe dëshirën për një jetë të lirë.

Me një fjalë, dashunia për gjuhën e për popullin, krenaria kombëtare dhe mënia e mallkimi kundër së keqes, kundër pushtuesit, ziejnë e shpërthejnë nga zemra e Pjetër Budit jo vetëm në prozë por edhe në vargje, të cilat me të drejtë u quejtën sokllimët e para të Muzës shqiptare.

## R é s u m é

PJETËR BUDI  
LE PREMIER POÈTE DE NOTRE LITTÉRATURE

*Du nombre des anciens écrivains albanais, Pjetër Budi, en dehors de sa prose, occupe une place importante aussi comme premier poète de notre littérature. Sa production, sur des sujets tirés de l'ancien et du nouveau testaments, se chiffre à plus de 3 000 vers.*

*On n'est pas en état de distinguer exactement quelles sont les productions originales et celles traduites ou adaptées. Mais le fait c'est que P. Budi, constatant que plusieurs des intellectuels de son temps ne prenaient pas, pour différentes raisons, une initiative dans le domaine de l'écriture et de la publication, se mit lui-même au travail. Et cela il le fit non seulement dans le domaine de la prose, mais également de la poésie, parce qu'il ressentait très profondément ce devoir patriotique.*

*Budi utilise dans ses vers l'octosyllabe, qui représente le vers le plus populaire de notre pays.*

*Dans une grande partie des vers de P. Budi on trouve l'accent «sui generis», typique à l'octosyllabe populaire. Un tel rythme auront plus tard aussi plusieurs vers de Naim Frashëri, dans son Histoire de Skanderbeg.*

*Chez Budi on assiste aussi à un effort à combiner les vers avec un goût typiquement littéraire. Dans la description de certains épisodes, il y a des expressions efficaces, animées, douces, d'après le sujet qu'il traite. Il parvient ainsi à faire susciter des émotions chez le lecteur. Les poésies de Budi ont leur importance aussi pour ce qui est de leur contenu.*

*Le poète arbëresh, Zef Skirò, considère que sous le voile de l'allégorie des productions de Budi, le péché et la diable personnifient le Turc lui-même, l'oppresseur de son pays.*

*Mais, au-dessus de tout, Budi a le mérite d'être le premier poète de notre littérature, c'est pourquoi à juste titre a-t-on appelé ses vers la première manifestation de la muse albanaise.*